

 Republika e Kosovës Republika Kosovo	DREJTORIA PËR ARSIM DHE KULTURË		 Komuna e Istogut Opština Istok
	05 Nr.254/18	Data:27.06.2018	

Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë duke u bazuar në 11 paragrafi 1 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-149 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.72/2010),nenit 34 paragrafi 5 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar Nr.04/L-032 , nenit 5 pika c e Ligjit për Arsim në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 2 pika 2 të UA Nr.08/2014,për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues, shpall :

RISHPALLJE TË KONKURSIT

Titulli i vendit të punës:

1. Zv.Drejtor i Shfmu "Bajram Curri " në Istog,-nr.ref.RN.0000

Detyrat dhe përgjegjësitë e zv.Drejtorit të shkollës:

Sipas UA nr.04/2003, Organet qeverise,profesionale dhe personeli tjetër i shkollës, neni 8, i përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e zëvendësuesit të shkollës. Detyrat dhe ngarkesat tjera janë ato që saktësohen me Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës,neni 20 ,Statusin dhe Rregulloren Komunale nr.6/2012 ,neni 12 dhe udhëzimet administrative të MASHT-it , përcaktohen disa nga detyrat dhe obligimet e zv.drejtorit të institucionit edukativo-arsimor.

1. Në mungesë e zëvendëson drejtorin e shkollës;
2. Ndihmon Drejtorin e shkollës në administrim dhe menaxhim të aktiviteteve në shkollë;
3. Bashkërendon aktivitetet profesionale të gjithë mësuesve;
4. Kujdeset për mirëqenjen dhe sigurinë në shkollë;
5. Ndihmon punën me prindër;
6. Mbanë orë mësimi kur ka mungesa të mësuesve;
7. Kryen detyra që i përcaktohen nga drejtori i shkollës.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë konkurrim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët janë në posedim të drejtave civile dhe politike që ka përgaditjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës menaxheriale në institucionin edukativ-arsimor.

Shkollimi i kërkuar:

- Të ketë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor 4 vjeçar, 240 ECTS.
- Të ketë diplomë Universitare nga profilet arsimore të pranueshme për pozitën e mësuesit sipas Udhëzimit për licencimin e mësuesve dhe sipas normativit për kuadrin mësimor dhe rregullat tjetër ligjore.
- Të ketë licencë të rregullt për mësuesi ose të jenë në përfundim të procedurës së licencimit.

Përvoja, aftësitë dhe atributet tjera:

- Së paku tri (3) vite përvojë pune në arsim.
- Të ketë të përfunduar me sukses një nga programet e akredituara të kualifikimeve profesionale për udhëheqje , administrim ose menaxhim të institucioneve edukativo - arsimore;

- Njohuri lidhur me ligjet, rregulloret e aplikueshme në fushën e arsimit dhe njohuritë lidhur me dokumentacionin shkollor dhe pedagogjik të nxënësve.
- Shkathtësi në komunikim, planifikim dhe koordinim të punës së personelit në nivel të shkollës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve e këshillave profesionale;
- Shkathtësi në komunikimin elektronik, kompjuterik në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access etj);

Kohëzgjatja e emrimit: Emërimi është me mandat 4 vjeçar.

Koeficienti: Për zv.drejtor të shmu është 7.2

Orët e punës: 40

Dokumentet e nevojshme:

- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe kopja e letërnjoftimit),
- Diploma e kualifikimit,
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT,
- Dëshminë e licencës së mësimdhënësit (vendimi dhe licenca), ose dëshmia që është në procedurë të licencimit,
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim,
- Portfolio profesionale (sipas udhëzimeve në Shtojcën G të MASHT-it ,UA nr 08\ 2014),
- Letër - referencë nga një institucion publik kredibil si(MASHT , DKA, Këshilli drejtues i shkollës , punëdhënësi paraprak ose nga institucionet e arsimit të lartë). Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuuese për punën dhe angazhimin paraprak.
- Plani zhvillimor i institucionit edukativ arsimor dhe aftësues për të cilin konkuron (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5 dhe me font të shkronjave Ariel, madhësia 11, sipas udhëzimeve të MASHT)
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore e kandidatit dhe
- Dëshmia se kandidati nuk është nën hetime.

Afati i konkursit;

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë ”.

Kandidatët e interesuar i marrin formularët e kërkesave në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në hyrje të ndërtesës së komunës zyra nr.100. Kërkesën bashkë me dokumentacion të nevojshëm e dorëzojnë në të njëjtën zyrë.

Vërejtje:

Dokumentat e pakompletuara dhe ato të arritura pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Hajrush Shoshi

Drejtori i DKA-së

